

---

# LIGJ

Nr. 125/2013

## **PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me ligjin nr. 88/2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126/2014)*

*(Ndryshuar me ligjin nr. 77/2015, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 132/2015)*

*(Ndryshuar me ligjin nr. 50/2019, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126/2019)*

**Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,**

### **KUVENDI I**

### **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

### **VENDOSI:**

1 Ky ligj përaftron direktivën 2004/18/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 31 marsit 2004 për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime, numri CELEX: 32004L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 134, datë 30.4.2004, faqe 114-240.

### **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJTTSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi i ligjit**

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë një kuadër të favorshëm dhe të qëndrueshëm për nxitjen, thithjen dhe krijimin e lehtësive për investimet që realizohen si koncesione/partneritete publike private.

#### **Neni 2**

#### **Objekti i ligjit**

Ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktuese për të hyrë në marrëveshje koncesionesh/partneritetesh publike private, për investime të bazuara në koncesione/partneritete publike private, procedurat për dhënien e kontratave të tilla, si nënshkrimi, ndërprerja dhe ndryshimet e marrëveshjeve të koncesionit/partneritetit publik privat, çështjet që kanë të bëjnë me rregullimet financiare dhe mbështetjen, në lidhje me koncesionet/partneritetet publike private, politikën e këtyre koncesioneve e autoritetin për zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera që lidhen me koncesionet/partneritetet publike private.

## Neni 3

### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Koncesion" është koncesioni i punëve publike ose koncesioni i shërbimeve publike.
2. "Koncesioni i punëve publike" është një marrëveshje me interes financiar, e lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është kryerja e punimeve, ku shpërblimi për punimet që duhet të kryhen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.
3. "Koncesioni i shërbimeve publike" është një marrëveshje me interes financiar në formë të shkruar ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, objekti i së cilës është sigurimi i shërbimeve, ku shpërblimi për shërbimet që do të sigurohen përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.
4. "Koncesion i përzier" është një koncesion, objekti i të cilit është kryerja e punimeve dhe sigurimi i shërbimeve, që identifikohet si koncesion i punëve publike ose koncesion i shërbimit publik dhe ku vendimtar për të përcaktuar nëse një kontratë e tillë është koncesion i punëve publike apo një koncesion i shërbimeve publike është elementi nëse puna që do të kryhet është objekti kryesor i kontratës apo nëse puna është thjesht karakteristike për shërbimin publik që është objekt i kontratës.
5. "E drejta për të shfrytëzuar veprat dhe/ose shërbimet" ka kuptimin e mëposhtëm:
  - a) e drejta për të nxjerrë të ardhura, në përputhje me kontratën e koncesionit; si dhe
  - b) transferimi të koncesionari i një pjese të konsiderueshme të riskut operacional, që lidhet me objektin e një koncesioni të punëve publike ose të shërbimeve publike. Do të quhet se koncesionari ka marrë një pjesë të konsiderueshme të riskut operacional, në qoftë se mbështetja financiare e dhënë direkt ose indirekt nuk garanton se do të realizojë kthimin e investimit apo mbulimin e kostove që rezultojnë nga menaxhimi i punëve dhe/ose i shërbimeve, të cilat janë objekt i koncesionit. Risku operacional ka kuptimin e riskut, që lidhet me përdorimin e veprave ose ofrimin e shërbimeve ose riskun që lidhet me disponueshmërinë e objektit të infrastrukturës që ndërtohet ose përdoret për të siguruar shërbime për përfituesit fundorë, në përputhje me kontratën e koncesionit.
6. "Komunikimi me shkrim" është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, të kopjohen dhe të komunikohen, përfshirë dhe informacionin që transmetohet dhe ruhet me mjete elektronike.
7. "Realizimi i punëve" është projektimi dhe realizimi me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me objektin e koncesionit dhe me kërkesat e specifikuar nga autoriteti kontraktues.
8. "Punë" është objekti, i cili është rezultati i ndërtimit ose i veprave civile inxhinierike, të marra si një tërësi, e cila është e mjaftueshme në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik ose teknik.
9. "Sigurimi i shërbimeve" është sigurimi apo realizimi i shërbimit publik që korrespondon me objektin

e koncesionit dhe me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktues.

10. "Objekti i koncesionit" janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruara në bazë të një marrëveshjeje koncesioni në çdonjërin nga sektorët e ligjshëm të renditur në këtë ligj.

11. "Koncesionari" është operatori ekonomik ose subjekti për qëllime të veçanta, me të cilin autoriteti kontraktues ka nënshkruar një kontratë koncesioni.

12. "Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)" është<sup>2</sup> :

a) një person juridik privat, me seli në Republikën e Shqipërisë, i krijuar me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata.

b) një formë e partneritetit publik privat që konsiston në krijimin e një entiteti të përbashkët të partnerit publik dhe atij privat, që kryen punë apo shërbime në bazë të një kontrate koncesioni / partneritetit publik privat dhe ku partnerit privat përveç kontributit në kapital apo asete, edhe në pjesëmarrje aktive në menaxhimin e kontratës së koncesionit /PPP. Kontributet e thjeshta të kapitalit nga investitorët privatë në kompanitë shtetërore nuk përbëjnë SPV.

13. "Projekte" janë një sërë aktivitetesh të ndërlidhura, që ndërmerren në një mënyrë të caktuar, me qëllimin e arritjes së objektivave të qartë brenda një periudhe kohore të specifikuar dhe brenda një kuadri të caktuar financiar.

14. "Objekti" është rezultati i ndërtimit ose i një infrastrukture ekzistuese publike në posedim, që përdoret ose zotërohet nga koncesionari/partneri privat ose një infrastrukturë publike që do të realizohet në zbatim të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe që mund të sigurohet për të mirën e publikut ose të ndonjë pjese të publikut.

15. "Propozim i pakërkuar" është propozimi për të marrë përsipër projekte koncesioni, i cili nuk ka ardhur në përgjigje të një kërkesë të bërë nga autoriteti kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese.

16. "Mbështetja financiare" është lloji i mbështetjes monetare ose jomonetare dhe/ose financimi i dhënë nga sektori publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar, subvencione, garanci financiare apo të tjera, kontribute kapitale dhe transferim të të drejtave të pronësisë.

17. "Vlera e parasë" është një term, i cili përdoret për të përcaktuar nëse autoriteti kontraktues ka marrë fitimet maksimale të mundshme nga punët apo shërbimet e dhëna me koncesion/partneritet publik privat. Ky term nuk kufizohet në masën e vlerës së parasë së punëve/shërbimeve, por përfshin, gjithashtu, edhe vlerësimin e cilësisë, kostos dhe shfrytëzimin e burimeve, përshtatshmërinë me qëllimin dhe objektivin e kontratës, kohën dhe mundësinë për të vendosur nëse të gjitha këto elemente të kombinuara përbëjnë vlerën me të mirë ekonomike.

18. "Kontraktues" është çdo person, fizik ose juridik, ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të

---

<sup>2</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar".

tilla që ofrojnë në treg, respektivisht, realizimin e punëve dhe/ose të punëve dhe shërbimeve.

19. "Operator ekonomik" është kontraktuesi, sipërmarrësi i punëve ose shërbimeve.

20. "Procedura e shpalljes së fituesit" është procedura e hapur, e kufizuar ose e negociuar, e rregulluar me ligjin e prokurimit publik, që realizohet nga autoriteti kontraktues, në mënyrë që të japë një koncesion/partneritet publik privat.

21. "Dokumentet e tenderit" janë dokumentet që autoriteti kontraktues ua vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm si një bazë për përgatitjen e ofertave të tyre.

22. "Kontratë koncesioni" është një kontratë e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë.

23. "Kontratë e partneritetit publik privat" ka kuptimin e një kontrate pune publike apo kontrate të shërbimit publik, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një partneritet publik privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj dhe që nënshkruhet ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatori ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm.

24. "Nënshkruesi i autorizuar" është një person i autorizuar nga autoriteti kontraktues për të nënshkruar një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat.

Përveçse kur rregullohet ndryshe nga ky ligj, kuptimi i termave të përcaktuar në ligjin e prokurimit publik zbatohet për këtë ligj në përputhje me rrethanat.

## **Neni 4**

### **Fusha e zbatimit të koncesioneve/partneriteteve publike private**

1. Koncesionet/partneritetet publike private mund të jepen për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve për sektorët dhe qëllimet e mëposhtme:

a) transport (sistemin e hekurudhave, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimin, transportin publik);

b) prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje;

c) prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, shpërndarje dhe menaxhim i ujërave të zeza, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave;

ç) menaxhim i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e tyre;

d) telekomunikacion; dh) shkencë dhe arsim;

e) turizëm, argëtim dhe hoteleri;

- ë) kulturë dhe sport;
- f) shëndetësi;
- g) shërbime sociale;
- gj) burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;
- h) rehabilitim i tokës dhe pyjeve;
- i) parqe industriale, miniera dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;
- j) strehim;
- k) godina të administratës publike, teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;
- l) shpërndarje e gazit natyror;
- ll) rehabilitim dhe zhvillim urban dhe suburban.
- m) **ndriçimi publik në territorin e njësive administrative vendore**<sup>3</sup>
- n) bujqësi<sup>4</sup>

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrive të linjës apo propozime që këto i marrin nga autoritete të njësive të qeverisjes vendore apo të organeve qendrore të politikës së koncesioneve/partneriteteve publike private, vendos për koncesionet/partneritetet publike private që zbatohen në sektorë të tjerë.

3. Në raste të veçanta, Këshilli i Ministrave mund të ofrojë koncesione për operatorët ekonomikë, vendas apo ndërkombëtarë, me çmimin simbolik 1 euro.

## **Neni 5**

### **Përfshirjet**

1. Ky ligj nuk zbatohet për koncesionet/partneritetet publike private, në rastet e mëposhtme:

- a) nën kufirin e ulët monetar;
- b) kur realizimi i tyre duhet të shoqërohet me masa të veçanta të sigurisë, në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi apo kur një gjë e tillë kërkohet nga mbrojtja e interesave

---

<sup>3</sup> Shtuar me Ligjin nr. 88/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>4</sup> Shtuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

thelbësorë të shtetit;

c) për blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjetesh financiare, të pasurisë së paluajtshme ose të të drejtave të lidhura me to. Megjithatë, kontratat e shërbimeve financiare, të nënshkruara në të njëjtën kohë para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë, në çfarëdo forme, I nënshtrohen këtij ligji;

ç) për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialeve të programit apo reklamave të destinuara për transmetim nga transmetuesit ose për publikimin në media dhe kontratat për kohën e transmetimit;

d) për koncesionet, të cilat u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që jepen në përputhje me rregullat procedurale të veçanta të organizatave ndërkombëtare;

dh) për shërbimet e arbitrazhit dhe të pajtimit;

e) për shërbimet financiare, në lidhje me nxjerrjen, shitjen, blerjen, apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, në mënyre të veçantë, transaksionet nga autoritetet kontraktuese për të mbledhur para ose kapital;

ë) për të gjitha shërbimet e përmendura në procedurat për dhënien e kontratave sektoriale në ligjin e prokurimit publik;

f) për shërbimet e transportit ajror;

g) për koncesione/partneritete publike private që u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që janë dhënë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i ka lidhur me një ose disa shtete të tjera, të nënshkruara në pajtim me Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Europian dhe që përfshijnë punë, mallra apo shërbime të destinuara për zbatimin e përbashkët ose përdorimin e projekteve nga ana e vendeve nënshkruese;

gj) për koncesionin/partneritetin publik privat, në atë masë që ky ligj bie ndesh me një detyrim të shtetit, që është në bazë ose që rrjedh prej një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera a me një organizëm ndërkombëtar, mbizotërojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Në të gjitha aspektet e tjera, procedurat dhe parimet e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat rregullohen me këtë ligj;

h) për koncesionet e shërbimit publik që një autoritet kontraktues ia ka dhënë një autoriteti tjetër kontraktues ose një shoqate të autoriteteve kontraktuese, në bazë të një të drejte ekskluzive që ata gëzojnë, sipas legjislacionit në fuqi;

i) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, përveç hidrocentraleve me kapacitet të instaluar mbi 2 MW<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

## j) Shfuqizuar<sup>6</sup>

2. Rastet e përjashtuara, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen me dispozita të tjera ligjore ose nënligjore.

### **Neni 6**

#### **Licencat dhe lejet**

Ky ligj nuk zbatohet për licencat dhe lejet administrative që u jepen operatorëve ekonomikë, autoriteteve kontraktuese, enteve kontraktuese dhe organeve të tjera të sektorit privat apo publik.

### **Neni 7<sup>7</sup>**

#### **Koncensionet per hidrocentralet**

**(Shfuqizuar)**

### **Neni 8**

#### **Partneriteti publik privat**

1. Partneriteti publik privat nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues, domethënë partnerit publik, dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, domethënë partnerit privat, ku:

a) partneri privat merr përsipër detyrimin për t'u ofruar shërbime publike përdoruesve të shërbimeve brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për t'u ofruar shërbimet publike përdoruesve të shërbimeve dhe/ose veprimtaritë brenda fushës së kompetencave të tij;

b) partneri privat, me qëllim që të përmbushë detyrimet e shkronjës "a" të kësaj pike, mund të marrë përsipër:

i) detyrimin që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë/të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe /ose të rindërtuar/të rinovuar rishtazi;

ii) detyrimin që të përdorë, të operojë dhe të mirëmbajë një objekt ekzistues të infrastrukturës publike;

iii) çdo kombinim i detyrimeve të përmendura më lart, për sa kohë që kombinimi i këtyre detyrimeve

---

<sup>6</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncensionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>7</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

është për qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike;

c) në kuadër të marrjes përsipër të detyrimeve të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, partneri privat zakonisht merr përsipër nivele dhe shtrirje të ndryshme të risqeve, që lidhen me financimin, ndërtimin, kërkesën dhe/ose disponueshmërinë, dhe të tjera si operimi, menaxhimi, mirëmbajtja dhe risqet teknike, varësisht nga forma e partneritetit publik privat dhe varësisht nga përcaktimi, rast pas rasti;

ç) për kohëzgjatjen e partneritetit publik privat çdo partner zakonisht merr përgjegjësinë për rastet e riskut që janë nën sferën e ndikimit të tij ose përgjegjësia ndahet;

d) partneri privat shpërblehet kryesisht, por jo ekskluzivisht, dhe në përputhje me kontratën:

i) duke iu dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat publike dhe/ose shërbimin publik,

kryesisht me qëllimin e vendosjes së tarifave ose pagesave nga përdoruesit fundorë dhe konsumatorët ose kjo e drejtë së bashku me mbështetjen financiare;

ii) me pagesat e rregullta të drejtpërdrejta të paguara nga ose në emër të partnerit publik, zakonisht në lidhje me disponueshmërinë e objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;

iii) me forma të tjera të mbështetjes financiare, duke përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të drejtave të tjera reale;

iv) një kombinim i mjeteve të përshkruara më lart;

dh) partneri publik i mundëson partnerit privat kryerjen e aktiviteteve tregtare, të përcaktuara në kontratë së bashku me detyrimet që rrjedhin nga shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, nëse kjo siguron nivelin e nevojshëm të efikasitetit të kostos së pjesëmarrjes private dhe kthimit të arsyeshëm të investimit, si dhe një vlerë më të mirë të parasë.

2. Përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen, partneriteti publik privat mund të përfshijë krijimin e një subjekti për qëllime të veçanta (SPV) me kapital të përzier, që zotërohet bashkërisht nga partneri publik dhe privat. Nëse kontributet kapitale të partnerit publik janë të tilla që vlera ose ndikimi i tyre eliminojnë transferimin e nevojshëm të risqeve kryesore të natyrshme të projektit të partnerit privat, siç rregullohet nga ky ligj, një kontratë apo ndërmarrje e tillë nuk konsiderohet si një partneritet publik privat (PPP).

3. Kontratat e prokurimit publik, që nuk i plotësojnë kushtet e këtij neni, nuk konsiderohen partneritet publik privat. Kushte të tilla nënkuptojnë, por nuk kufizohen vetëm në kohëzgjatjen e kontratës, transferimin e risqeve kryesore të natyrshme dhe mjetet e shpërblimit.

4. Varësisht nga mjetet e shpërblimit, si dhe ndarja e risqeve kryesore të natyrshme, një partneritet publik privat mund të realizohet në një nga format e mëposhtme:

a) si punë publike me koncesion;

b) koncesion i shërbimeve publike;



c) kontratë e punëve publike;

ç) kontratë e shërbimit publik.

5. Këshilli i Ministrave miraton një dokument strategjik politikash për përcaktimin e sektorëve parësorë për investime të bazuara te partneriteti publik privat, të formave të preferuara të partneritetit publik privat dhe çështje të tjera që lidhen me kuadrin e përgjithshëm të politikave për koncesionet dhe partneritetet publike private në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 9**

### **Parimet themelore**

Procedura për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private zbatohet në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe të sigurisë ligjore.

## **Neni 9/1**

### **Ministria përgjegjëse për ekonominë<sup>8</sup>**

Ministria përgjegjëse për ekonominë është institucioni përgjegjës, i cili orienton dhe harmonizon veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve/PPP.

## **Neni 10**

### **Ministria përgjegjëse për financat**

1. Autoriteti i ministrisë përgjegjëse për financat, lidhur me koncesionet/PPP, ushtrohet sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për financat vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet e koncesionit/(PPP), si dhe çdo ndryshim apo transferim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Nëse autoriteti kontraktues nuk e ka shpallur operatorin fitues brenda 2 viteve nga marrja e miratimit nga ministria përgjegjëse për financat, do të dërgojë studimin e fizibilitetit të rishikuar edhe një herë për miratim.

3. Autoritetet kontraktuese janë të detyruara që përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit/PPP me ofertuesin ekonomik të shpallur fitues ta paraqesin atë për vlerësim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, në ministrinë përgjegjëse për financat.<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Shtuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>9</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

4. Autoritetet kontraktuese i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, ministrit përgjegjës për financat raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. Forma, përmbajtja dhe afatet e raporteve të monitorimit përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit përgjegjës për financat.
5. Bazuar në raportet e monitorimit, të specifikuara në pikën 4, të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat mund t'u rekomandojë autoriteteve kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.
6. Autoritetet kontraktuese, brenda gjashtëmuajorit të parë të çdo viti, dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për financat pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare.
7. Ministri përgjegjës për financat përgatit një raport vjetor të përmbledhur mbi ecurinë e kontratave aktive të koncesionit/PPP, si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.
8. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për vlerësimin dhe miratimin e projekteve, sipas pikës 2 të këtij neni.<sup>10</sup>

## **Neni 11**

### **“Agjencia e Prokurimit Publik”<sup>11</sup>**

Agjencia e Prokurimit Publik kryen detyrat e mëposhtme:

- a) monitoron respektimin e procedurave konkurruese të koncesioneve/PPP sipas legjislacionit për prokurimet publike pas nënshkrimit të kontratës dhe në rast të shkeljeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba ose propozon marrjen e masave administrative;
- b) përjashton një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik, nga përfitimi i kontratave publike.”<sup>12</sup>
- c) kryen publikimin e dokumenteve standarde të tenderit

## **Neni 12<sup>13</sup>**

### **“Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”<sup>14</sup>**

1. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, për të nxitur dhe asistuar autoritetet kontraktuese në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/partneriteteve publike private.

---

<sup>10</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>11</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>12</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>13</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>14</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

2. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) asiston Autoritetet Kontraktore me qëllim:

- a) Përgatitjen e studimit të fizibilitetit
- b) Përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriteret e vlerësimit;
- c) Vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;
- d) Negocimet dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.
- e) Monitorimin e kontratave të koncesionit;

3. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) gjithashtu:

- a) propozon pranë Ministrisë përgjegjëse për ekonominë ndryshimin e legjislacionit në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, si dhe udhëzimet për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- b) monitoron, analizon dhe studion tendencat aktuale evropiane dhe globale, të njohurive dhe përvojës në fushën e koncesioneve/ partneriteteve publike private;
- c) bashkëpunon me APP për hartimin dhe publikimin e dokumenteve standarde të koncesionit/PPP.
- c) i propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimeve të fizibilitetit të projekteve të koncesionit/PPP;
- d) i propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP kërkesat e ministrisë përgjegjëse për financat për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponentëve të studimeve të fizibilitetit të projekteve të koncesionit/PPP;
- dh) i propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponentëve të propozimeve të pakërkua;
- e) kryen procedurat e përzgjedhjes së konsulentëve të jashtëm, në përputhje me procedurat e prokurimit publik.”.

3/1. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve siguron të ardhura nga shërbimet që ofron si dhe nga donatorë vendas apo të huaj.<sup>15</sup>

4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>16</sup>

## Neni 12/1

### Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP

1. Për përzgjedhjen e projekteve të koncesionit/PPP, të cilat do të mbështeten me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose në kryerjen e oponentëve të tyre, krijohet Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, organ administrativ kolegjal, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe në përbërje të tij ka këta anëtarë:

<sup>15</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>16</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

- a) ministrin përgjegjës për financat;
  - b) ministrin përgjegjës për infrastrukturën;
  - c) ministrin përgjegjës për energjinë dhe industrinë;
  - ç) ministrin përgjegjës për zhvillimin urban;
  - d) ministrin përgjegjës për mjedisin.
2. Komiteti fton, rast pas rasti, pa të drejtë vote, përfaqësues nga bota akademike, si dhe titullarët e autoritetit kontraktues, të cilët kanë fushë të veprimtarisë objektin e projektit të koncesionit/PPP, për të argumentuar kërkesën e tyre.
  3. Komiteti shqyrton dhe miraton kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetjen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit të projekteve të mundshme të koncesionit/PPP.
  4. Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregulloren për mënyrën e funksionimit të tij dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit të projekteve të mundshme të koncesionit/PPP.
  5. Rolin e Sekretariatit të Komitetit e kryen Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, e cila mundëson të gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve”.<sup>17</sup>

## Neni 13

### Autoritetet kontraktuese

1. Autoritetet kontraktuese janë organet, të cilave ky ligj u jep kompetencat për të ndërmarrë një procedurë për dhënien e koncesioneve/partneriteteve publike private.
2. Autoritetet kontraktuese janë<sup>18</sup>:
  - a) Ministritë e linjës;
  - b) Njësitë e qeverisjes vendore.
3. Kur objekt i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat është fushë e veprimtarisë së më shumë se një Autoriteti Kontraktor, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton Autoritetin Kontraktor/Autoritetet Kontraktore, sipas rastit.<sup>19</sup>

## Neni 14

### Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat

---

<sup>17</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>18</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>19</sup> Shtuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

1. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat është një bazë të dhënash elektronike e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të dhëna në Republikën e Shqipërisë.

2. Regjistri i koncesionit/partneritetit publik privat krijohet dhe mbahet nga

“Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)” në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.<sup>20</sup>

3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për përmbajtjen dhe formën e regjistrit të koncesioneve/partneritetit publik privat.

## Neni 15

### Konfidencialiteti

Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë konfidencialitetin, zbatohen edhe për koncesionet/partneritetet publike private të rregulluara me këtë ligj.

## KREU II

### VEPRIMET PËR DHËNIEN E KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT<sup>21</sup>

## Neni 16<sup>22</sup>

Veprimet për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat

1. Veprime për dhënien e një koncesioni/partneriteti publik privat quhen të gjitha aktivitetet e ndërmarra që nga identifikimi i projekteve deri në fazën e monitorimit të kontratës në zbatim të këtij ligji.
2. Autoriteti kontraktues mund të angazhojë keshilltare të jashtëm për të siguruar mbështetjen e ekspertëve në përgatitjen dhe dhënien e projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat.

2/1. Në rast se autoriteti kontraktues kërkon mbështetjen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose oponencën e projekteve të koncesionit/PPP, i drejtohet me kërkesë të argumentuar Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve. Kërkesa duhet të përmbajë argumente mbi përshtatshmërinë, nevojën dhe elemente të leverdishmërisë së dhënies së këtij projekti me koncesion/PPP, si dhe referencat për ekspertizën e duhur. Në çdo rast, për projektet me vlerë mbi 100 000 000 euro, autoritetet kontraktuese i drejtohen Komitetit për Përzgjedhjen e Projekteve të Koncesionit/PPP për mbështetje me ekspertizë”.<sup>23</sup>

3. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të hollësishme në zbatim të këtij neni.<sup>24</sup>

## Neni 17

### Identifikimi i projekteve të mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat

<sup>20</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>21</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar

<sup>22</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>23</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>24</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

1. Autoriteti kontraktues identifikon dhe shqyrton projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat brenda sferës së kompetencave të tij.

2. Autoriteti kontraktues informohet dhe mund të marrë në shqyrtim projektet e mundshme të koncesionit/partneritetit publik privat të identifikuar apo të propozuara nga:

a) Kryeministria;

b) autoritetet e tjera kontraktuese të së njëjtës hierarki administrative, organet e qeverisjes qendrore apo vendore;

c) institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare financiare dhe të zhvillimit; ç) institucionet dhe organizatat shkencore vendase dhe ndërkombëtare;

d) operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pakërkua vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.<sup>25</sup>

3. Shfuqizuar<sup>26</sup>.

4. Shfuqizuar<sup>27</sup>

## Neni 18<sup>28</sup>

### **Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat**

1. Për shqyrtimin dhe dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat, autoriteti kontraktues në koordinim me Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) krijon komisionin e koncesionit/partneritetit publik privat.

2. Anëtarët e komisionit duhet të jenë me profesion jurist, ekonomist, profesion teknik dhe profesione nga fusha të tjera përkatëse, në varësi të objektit dhe karakteristikave të koncesionit/partneritetit publik privat.

3. Numri i anëtarëve në komisionin e dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat është tek, por jo me pak se 5 anëtarë, nga të cilët jo më pak se dy prej anëtarëve janë nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO). Për projekte koncesioni/PPP objekti i të cilave është i ngjashëm në natyrë, mund të emërohet një komision i vetëm.

4. Anëtarët e komisionit të koncesionit /partneritetit publik privat nuk duhet të kenë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë privat në asnjë prej aktiviteteve që përbëjnë konflikt interesi, në përmbushje të detyrave si anëtarë të këtij komisioni, gjë të cilën ata e konfirmojnë me nënshkrimin e një deklaratë që garanton se nuk kanë konflikt interesi, sipas parashikimeve në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

5. Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat kryen detyrat e mëposhtme:

a) Harton studimin e fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat, përcakton procedurën e zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe harton dokumentacionin e tenderit;

b) Shqyrton dhe vlerëson ofertat e pranuar dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje që janë dorëzuar;

<sup>25</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>26</sup> Shfuqizohet me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>27</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>28</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

- c) Formulon propozimin e përzgjedhjes së ofertës së suksesshme ose propozimin e vendimit për ndërprerjen e procedurës së prokurimit, si dhe një shpjegim të tyre;
- d) Kryen të gjitha aktivitetet e tjera që kërkohen për zbatimin e procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat, në përputhje me rregulloret në fuqi.

5. Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat mban procesverbale për pasqyrimin e punës së tij, të cilat duhet të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit.

## **Neni 19**

### **Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat**

1. Studimi i fizibilitetit për koncesionin/partneritetin publik privat hartohet nga komisioni i dhënies së koncesionit/PPP brenda 60 ditëve pune nga krijimi i këtij komisioni. Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditëve pune.<sup>29</sup>
2. Studimi i fizibilitetit përmban, në mënyrë të veçantë:
  - a) përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
  - b) analizat teknike, financiare, ekonomike dhe ligjore;
  - c) studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë;
  - ç) anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet.
3. Në studimin e fizibilitetit merren parasysh në veçanti interesi publik, ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit, treguesit e vlerës së parasë, harmonizimi i projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë, risqet direkte dhe indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore, mbështetja e nevojshme financiare, realizueshmëria teknike dhe tregtare, si dhe interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë.

#### **4.<sup>30</sup> Shfuqizuar**

5. Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat apo analiza e përmbledhur e dhënies me koncesion përmban:
  - a) përcaktimin e llojit dhe objektin e koncesionit/partneritetit publik privat;
  - b) vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisë qendrore dhe vendore;

---

<sup>29</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>30</sup> Shfuqizuar me Ligjin Nr.88/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

- c) vlerën e parashikuar të kontratës;
- ç) vlerësimet në lidhje me kriteret e zgjedhjes dhe të dhënies së koncesionit/partneritetit publik privat;
- d) kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit.

6. Përpara shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/PPP, autoritetet kontraktuese dërgojnë studimin e fizibilitetit, si dhe çdo ndryshim të mëtejshëm të tij, në ministrinë përgjegjëse për financat. Ministria përgjegjëse për financat e vlerëson dhe miraton studimin në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit.

7. Për qëllime të zbatimit të pikës 6, të këtij neni, autoriteti kontraktues duhet të dorëzojë studimin e fizibilitetit të objektit dhe draftkontratën pranë ministrisë përgjegjëse për financat.<sup>31</sup>

## Neni 20

### Llogaritja e vlerës së koncesionit/partneritetit publik privat

1. Autoriteti kontraktues llogarit vlerën e parashikuar të koncesionit/partneritetit publik privat si vlerë totale e objektit të koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e mundshme dhe opsionet e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, pa vlerën e TVSH-së.
2. Vlera e parashikuar e koncesionit llogaritet në bazë të të dhënave që përmban studimi i fizibilitetit përkatës ose analiza e përmbledhur e dhënies së koncesionit.
3. Vlera e parashikuar e partneritetit publik privat llogaritet sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik.

## Neni 21

### Dokumentet e tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen dhe trajtohen nga autoriteti kontraktues, në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji.<sup>32</sup>
2. Pa cenuar pikën 1 të këtij neni, në dokumentet e tenderit për procedurën për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat mund të përfshihet informacion shtesë, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

---

<sup>31</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>32</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.



## **KREU III**

### **PROCEDURA PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE/PARTNERITETEVE PUBLIKE PRIVATE**

#### **Neni 22<sup>33</sup>**

##### **Procedura e koncesioneve/partneriteteve publike private**

1. Procedura për dhënie e koncesioneve /partneriteteve publike private fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënie e kontratës ose me vendimin për ndërprejen e procedurës së dhënies së kontratës.
2. Procedura për dhënie e koncesioneve /partneriteteve publike private, me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.
3. Në dhënie e koncesioneve/partneriteteve publike private, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme.
4. Kur jepen koncesione të punëve publike, afati për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

#### **Neni 23<sup>34</sup>**

##### **Kriteret e vlerësimit për dhënie e kontratës së koncesionit/PPP.**

1. Kriteret e vlerësimit për dhënie e kontratës së koncesionit/PPP janë si më poshtë:  
oferta ekonomike dhe favorshme bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e koncesionit/PPP në fjalë si, për shembull, cilësia, e cila përfshin merita teknike, karakteristikat estetike, funksionale dhe të mjedisit, kostot e drejtimit, kosto të efektivitetit, ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike, datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve, çmimin e shërbimit për

---

<sup>33</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>34</sup> Ndryshuar me Ligj nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

- përfituesit fundorë, shumën e tarifës së koncesionit;
2. Komisioni i dhënies së koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e kontratës koeficientet relativë, që ai i jep secilit prej kritereve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Këta koeficiente mund të shprehen duke parashikuar një gamë më një shtrirje të përshtatshme maksimale. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të arsyeve të justifikuara, autoriteti kontraktues tregon në njoftimin e kontratës kriteret sipas rendit zbritës të rëndësisë.

### 3.<sup>35</sup> Shfuqizuar

4. Nëse ndonjë akt tjetër ligjor që rregullon koncesionet përcakton tarifën më të ulët të koncesionit, të cilën koncesionari është i detyruar ta paguajë, atëherë autoriteti kontraktues e deklaron këtë shumë në dokumentet e tenderit, si shuma të cilën ofertuesit duhet ta përfshijnë në ofertat e tyre.
5. Kriteret për dhënien e kontratës nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e koncesionit.

## Neni 24

### Njoftimi i kontratës së koncesionit

1. Autoriteti kontraktues bën të njohur qëllimin e tij për të dhënë një koncesion me anë të një njoftimi.
2. Në njoftimin e kontratës së koncesionit duhet të përfshihen të paktën të dhënat e mëposhtme:
  - a) emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të autoritetit kontraktues;
  - b) lloji, subjekti dhe objekti i koncesionit;
  - c) vendndodhja e veprimtarisë koncesionare që do të ndërmerret;
  - ç) kohëzgjatja e kontratës së koncesionit;
  - d) vlera e parashikuar e kontratës koncesionare;
  - dh) afati i fundit për dorëzimin e ofertave;
  - e) adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat;
  - ë) gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat;
  - f) koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave;
  - g) kriteret për përjashtimin e ofertuesve;
  - gj) kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional,

---

<sup>35</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

aftësinë teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënat, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla;

h) lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin;

i) kriteret për dhënien e kontratës;

j) emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës.

3. Palët e interesuara për procedurën konkurruese kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin ose korrigjimin e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese. Kjo kërkesë duhet depozituar brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës. Në rast se dokumentet e procedurës konkurruese ndryshohen ose korrigjohen, afati i fundit për dorëzimin e ofertave mund të shtyhet, në përputhje me rrethanat, por jo më shumë se 10 ditë.<sup>36</sup>

4. Njoftimi i kontratës botohet në një formular standard.

5. Përmbajtja e formularit standard përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Njoftimi i kontratës publikohet në formë elektronike në platformën elektronike të prokurimit dhe në Buletin e Prokurimit Publik.

7. Për të gjitha çështjet e njoftimit të kontratës, që nuk rregullohen nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, zbatohet ligji për prokurimin publik, në përputhje me rrethanat.

## Neni 25

### Propozimet e pakërkuara

1. Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.

2. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e koncesionit/PPP. Nuk do të pranohen propozimet e pakërkuara, të shoqëruara me studim në formë minimale.<sup>37</sup>

3. Kur procedura e dhënies së koncesionit/PPP e nisur mbi një propozim të pakërkuar finalizohet me nënshkrimin e kontratës, autoriteti kontraktues kompenson shpenzimet e bëra nga propozuesi për

---

<sup>36</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>37</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

4. Shuma e kompensimit për propozimin e pakërkuar nuk mund të jetë më e lartë se 1 % e vlerës së investimit. Vlera e përcaktuar e kompensimit do të publikohet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe do të paguhet nga ofertuesi i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës.
5. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkua dhe mënyrën e llogaritjes së shumës së kompensimit.<sup>38</sup>
6. Propozuesit i jepet një bonus për rezultatin teknik dhe/ose financiar të arritur gjatë procedurës konkurruese deri në një maksimum 10 % të pikëve totale të garës.
7. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkua.<sup>39</sup>

## KREU IV

### KONTRATA E KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

#### Neni 26

#### Lidhja e kontratës

1. Autoriteti kontraktues nuk mund të lidhë kontratën para skadimit të periudhës së pritjes së ankesave, e përcaktuar në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik.
2. Lidhja e kontratës para përfundimit të afatit të njoftimit të klasifikimit apo para se të ketë përfunduar shqyrtimi administrativ e bën atë absolutisht të pavlefshme.
3. Autoriteti kontraktues fton ofertuesin më të suksesshëm për lidhjen e kontratës, pas botimit të njoftimit të fituesit, në Buletinin e Njoftimeve Publike.<sup>40</sup>
4. Shfuqizohet.<sup>41</sup>
- 4/1. Pas negociimit të kontratës me operatorin e shpallur fitues dhe përpara nënshkrimit të saj, autoriteti kontraktues e dërgon projektkontratën për vlerësim përfundimtar, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit, në ministrinë përgjegjëse për financat.<sup>42</sup>
5. Kontrata hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga personi i autorizuar i autoritetit kontraktues dhe ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi.
6. Kur ofertuesi i përzgjedhur si më i suksesshmi, në përputhje me dokumentet e tenderit, me vendimin

<sup>38</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>39</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

<sup>40</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>41</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>42</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

për dhënien e kontratës fituese dhe me ofertën e zgjedhur, është i detyruar të krijojë një subjekt për qëllime të veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit "Shoqëri koncesionare" dhe me objekt "Objektin e kontratës së koncesionit", autoriteti kontraktues nënshkruan kontratën me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë.

7. Autoriteti kontraktues, me përfundimin e regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi, të shoqërisë koncesionare, dërgon një kopje të kontratës dhe ekstraktit të regjistrimit në Ministrinë e Financave.

8. Nëse ofertuesi i zgjedhur si më i suksesshmi tërhiqet nga lidhja e kontratës ose nuk dorëzon në kohën e përcaktuar garancitë dhe instrumentet e përshkruara në nenin 28 të këtij ligji, atëherë autoriteti kontraktues mund të marrë një vendim të ri për dhënien e kontratës dhe t'i ofrojë nënshkrimin e kontratës ofertuesit të radhës që është renditur si më i miri.

9. Kontratat e koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që marrin përsipër risqe fiskale, pas nënshkrimit nga palët dhe vetëm pas marrjes së vlerësimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 4/1 të këtij neni, dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave. Llojet dhe natyra e risqeve fiskale të mundshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>43</sup>

## Neni 27

### Përmbajtja e kontratës

1. Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

2. Çështjet e kontratës, që nuk rregullohen me këtë ligj, janë subjekt i dispozitave të Kodit Civil.

3. Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me informacionet që gjenden në njoftimin e kontratës, me ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së kontratës.

4. Përveç kontratës, autoriteti kontraktues ka të drejtën, në përputhje me këtë ligj, me dokumentet e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me ofertën e zgjedhur, të lidhë marrëveshje dhe/ose kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, rast në të cilin autoriteti kontraktues njofton paraprakisht Ministrinë e Financave.

5. Marrëveshje dhe/ose kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, të përshkruara në pikën 4 të këtij neni, quhen në veçanti ato, të cilat janë të lidhura për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e kontratës.

6. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullon, në përputhje me dokumentacionin e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me ofertën e zgjedhur, të gjitha çështjet që janë të lidhura me pronësinë e pasurive të paluajtshme dhe pasurive të tjera, që janë objekt i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe pronësinë e pasurive të paluajtshme ose jo, që lindin në bazë të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për kohëzgjatjen e saj apo pas përfundimit të saj.

---

<sup>43</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat"

## Garancitë e realizimit të kontratës

1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.). Sigurimi i kontratës do të jetë deri në 5 % të vlerës së kontratës dhe përcaktohet në dokumentet e tenderit. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por, në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25 % e vlerës fillestare të sigurimit.<sup>44</sup>
2. Garancitë dhe instrumentet e sigurisë depozitohen pranë autoritetit kontraktues, i cili është i detyruar t'i ruajë ato gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kontratës.
3. Autoriteti kontraktues verifikon rregullisht vlefshmërinë e instrumenteve të sigurisë.
4. Në bazë të pikës 3 të këtij neni dhe në rast se instrumenti i mbyllur i sigurisë nuk është i vlefshëm, autoriteti kontraktues i kërkon pa vonesë koncesionarit/partnerit privat të paraqesë një instrument të ri të sigurisë.

## Neni 29

### Tarifa e koncesionit

1. Nëse është përcaktuar në studimin e fizibilitetit, koncesionari paguan një kompensim monetar për koncesionin në shumën dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratën e koncesionit. **Përfshirja nga pagesa e kësaj tarife bëhet vetëm për rastet e koncesioneve që aplikohen në fushën e shëndetësisë<sup>45</sup> dhe në fushën e sportit<sup>46</sup>**
2. Tarifa koncesionare paguhet në përputhje me rregullat e caktuara nga Ministri i Financave për arkëtimin e të ardhurave për llogari të Buxhetit të Shtetit.
3. Shuma dhe afatet e pagesës së tarifës së koncesionit përcaktohen në përpjesëtim me objektin e koncesionit, me vlerën e parashikuar të kontratës së koncesionit, kohëzgjatjen e kontratës, risqet dhe kostot që koncesionari merr përsipër dhe fitimin e pritshëm, si dhe me nivelin e pajisjeve dhe vlerën e pronës së dhënë, sipas kontratës së koncesionit nga autoriteti kontraktues.
4. Kontrata e koncesionit mund të përcaktojë ndryshueshmërinë e shumës dhe/ose mënyrën e llogaritjes dhe të pagesës së tarifës së koncesionit brenda një periudhe kohore të caktuar, gjatë të gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit, në përputhje me dokumentacionin e tenderit dhe me vendimin për dhënien e kontratës.
5. Tarifat e koncesionit janë pjesë e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

<sup>44</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>45</sup> Shtuar me Ligjin Nr.88/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

<sup>46</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

dhe/ose të buxheteve të organeve të qeverisjes vendore.

6. Kur tarifa koncesionare nuk paguhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni, autoriteti kontraktues njofton ministrin përgjegjës për financat, urdhri i të cilit për arkëtimin e tarifës përbën titull ekzekutiv për bankat e nivelit të dytë ku ndodhet llogaria bankare e shoqërisë koncesionare që vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor.”<sup>47</sup>

### **Neni 30**

#### **Afati i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat**

1. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat lidhet për një periudhë të caktuar.
2. Autoriteti kontraktues përcakton në studimin e fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat afatin e kontratës, në mënyrë të tillë që kohëzgjatja e saj nuk e kufizon konkurrencën më shumë sesa është e nevojshme, që të sigurohet amortizimi i vlerës reale të investimeve të koncesionarëve/partnerëve privatë dhe një normë e arsyeshme e kthimit të investimit, duke marrë parasysh kostot dhe risqet e marra përsipër nga koncesionari/partneri privat për kohëzgjatjen e kontratës.
3. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se 35 vjet.
4. Afati kohor, për të cilin është dhënë koncesioni/partneriteti publik privat, fillon nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.
5. Afati kohor i kontratës mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të kontratës, siç parashikohet në nenet 31, 32 dhe 33 të këtij ligji.

### **Neni 31**

#### **Ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat**

1. Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.
2. Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari/partneri privat.
3. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese veçanërisht në rastet e mëposhtme:
  - a) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
  - b) kur humbet objekti i kontratës ose kur ek ziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në

---

<sup>47</sup> Shtuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

rastin e forcës madhore;

c) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;

ç) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve ose në realizimin e kontratës.

4. Ndryshimet e kushteve thelbësore të kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat.

5. Pa shkelur dispozitat e neneve 32 dhe 33 të këtij ligji, termi "kushtet thelbësore" u referohet në veçanti kushteve, të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe nëse ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e kontratës në atë masë që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet që nuk mbulohen fillimisht.

6. Për të gjitha ndryshimet e planifikuara të kontratës, autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit.

7. Çdo ndryshim i kontratës së koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që merr përsipër risqe fiskale, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 6, të këtij neni, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave nga autoritetet kontraktuese.<sup>48</sup>

## Neni 32

### **Transferimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat**

1. Në përputhje me dispozitat e këtij neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga autoriteti kontraktues, kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveçse nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari/partneri privat i mëparshëm.

2. Transferimi i kontratës së koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së kontratës.

3. Kur koncesionari/partneri privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e autoritetit kontraktues dhe të Ministrisë së Financave, përveçse nëse ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.

---

<sup>48</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”



4. Për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit.

5. Çdo transferim i kontratës së koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që merr përsipër risqe fiskale, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 4, të këtij neni, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave nga autoritetet kontraktuese.<sup>49</sup>

### **Neni 33**

#### **Rregullat për dhënien e punëve dhe shërbimeve shtesë për koncesionarët/partnerët privatë**

1. Autoriteti kontraktues mund t'i japë koncesionarit, pa kryer një procedurë të re për dhënien e koncesionit, punë dhe/ose shërbime shtesë, të cilat nuk janë të përfshira në kontratën bazë, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, bëhen të nevojshme për kryerjen e punës apo shërbimit të përshkruar në atë kontratë, të cilat autoriteti kontraktues ia ka dhënë koncesionarit, me kusht që kontrata t'i jepet koncesionarit që kryen punë ose shërbim, që është objekt i kontratës kur:

a) vepra të tilla ose shërbimet shtesë nuk mund të ndahen teknikisht ose ekonomikisht nga kontrata bazë, pa i shkaktuar vështirësi të mëdha koncesionarit; ose

b) këto punime ose shërbime, edhe pse të ndashme nga realizimi i kontratës bazë, janë të domosdoshme për përfundimin e saj.

2. Vlera e kontratave të dhëna për punët ose shërbimet shtesë nuk mund të tejkalojë 30 për qind të vlerës së kontratës bazë të koncesionit.

3. Për dhënien e punëve ose të shërbimeve shtesë operatorëve ekonomikë, që veprojnë si partnerë privatë, në rastin e partneriteteve publike private të realizuara si kontrata të punëve apo të shërbimeve publike, dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik zbatohen në përputhje me rrethanat.

4. Autoriteti kontraktues njofton Ministrinë e Financave për çdo dhënie të punëve ose shërbimeve shtesë, të bëra në përputhje me këtë nen.

### **Neni 34**

#### **Nënkontraktimi**

1. Autoriteti kontraktues mund:

a) t'i kërkojë koncesionarit që të japë kontrata që janë minimalisht 30 për qind e vlerës totale të kontratës së koncesionit të palët e treta, duke siguruar, në të njëjtën kohë, një mundësi për tenderuesit që ta rris in këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në kontratën e koncesionit;

b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të kontratës që ata

---

<sup>49</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

planifikojnë t'u caktojnë palëve të treta.

2. Për nënkontraktimin e partneriteteve publike private, që realizohen si kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të ligjit të prokurimit publik, në përputhje me rrethanat.

### **Neni 35**

Rregullat në fuqi për kontratat e punëve që u jepen palëve të treta nga koncesionarët e punëve publike

1. Këto rregulla zbatohen për punët publike të koncesionarëve, të cilat, sipas këtij ligji, nuk janë autoritete kontraktuese.

2. Kur një koncesionar u jep kontrata punësh palëve të treta në një vlerë të përlllogaritur mbi 700 000 000 lekë, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar, koncesionari zbaton rregullat e mëposhtme:

a) koncesionari publikon në mënyrë të detyrueshme dhe në një formular standard njoftimin e kontratës në Buletinin e Prokurimit Publik, me synimin për dhënien e kontratës së punëve palëve të treta;

b) afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje përcaktohet nga koncesionari dhe nuk duhet të jetë më i shkurtër se 37 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës;

c) afati i fundit për dorëzimin e ofertave përcaktohet nga koncesionari dhe nuk duhet të jetë më i shkurtër se 40 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, domethënë nga dërgimi i ftesave për dorëzimin e ofertave;

ç) me përjashtim të përcaktimit të shkronjave "b" dhe "c" të kësaj pike, në rastin kur kërkesa për pjesëmarrje dhe ofertat janë paraqitur me anë të mjeteve elektronike, zbatohet ligji i prokurimit publik, në përputhje me rrethanat, edhe për shkurtrimin e afateve të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni;

d) afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe ofertave shtyhen në një mënyrë, në të cilën të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm, në rastet e mëposhtme:

i) nëse dokumentacioni i tenderit dhe të gjitha informacionet shtesë nuk janë dhënë në afatet e parashikuara;

ii) nëse nuk sigurohet vizita dhe informacioni për vendin e ndërtimit dhe për të gjitha dokumentet e nevojshme për përgatitjen e ofertave.

3. Vlera e kontratave të përmendura në pikën 2 të këtij neni llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Grupet e shoqërive, të cilat janë formuar për të marrë koncesionin ose shoqëritë që lidhen me to nuk konsiderohen palë të treta.

5. "Shoqëri e lidhur" ka kuptimin e çdo shoqërie tjetër, që lidhet me koncesionarin nëpërmjet pronësisë,

kontrollit dhe drejtimit të përbashkët. Mund të realizohet në një nga format e mëposhtme ku:

- a) koncesionari mund të ushtrojë një ndikim mbizotërues, direkt apo indirekt, mbi shoqërinë;
- b) shoqëria mund të ushtrojë një ndikim mbizotërues, direkt apo indirekt, mbi koncesionarin.

6. Ndikimi mbizotërues nga ana e shoqërisë presupozohet kur, direkt apo indirekt, në lidhje me një shoqëri tjetër, ajo:

- a) mban shumicën e kapitalit të nënshkruar të shoqërisë;
- b) kontrollon shumicën e votave bashkëngjitur aksioneve të emetuara nga shoqëria; ose
- c) mund të emërojë më shumë se gjysmën e organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të shoqërisë.

7. Lista shteruese e shoqërive të tilla përfshihet në kërkesën për koncesion. Koncesionari informon autoritetin kontraktues për çdo ndryshim të mëvonshëm në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive.

### **Neni 36**

#### **Zgjidhja e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat**

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, autoriteti kontraktues mund të ndërpresë kontratën kur:

- a) mund të provojë se koncesionari/partneri privat nuk mund të kryejë detyrimet e veta, për shkak të paaftësisë pague, shkeljeve serioze apo çështjeve të tjera që pengojnë apo nuk lejojnë vazhdimin e kontratës, në përputhje me standardet teknike dhe me standardet e tjera të pranuar;
- b) koncesionari/partneri privat dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga nënshkrimi ose hyrja në fuqi e kontratës.

2. Secila palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

- a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave të secilës palë;
- b) ka shkelje serioze nga pala tjetër dhe se kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

3. Palët kanë, gjithashtu, të drejtë të zgjidhin kontratën me pëlqimin reciprok.

4. Para zgjidhjes së kontratës, në përputhje me këtë nen, autoriteti kontraktues informon Ministrinë e Financave për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e kontratës dhe kërkon mendimin e saj.

### **KREU V**

## **ÇËSHTJET FINANCIARE DHE ÇËSHTJET E LIDHURA**

### **Neni 37**

#### **Marrëdhëniet e pronësisë**

1. Në rast se një kontratë koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e pasurisë në pronësi të një personi , që nuk është i përfshirë në procedurën për dhënie të kontratës, marrëdhëniet e pronësisë që shoqërojnë një pasuri të tillë duhet të zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi, në mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.
2. Nëse Republika e Shqipërisë është pronare e pasurisë së paluajtshme, të përfshirë në realizimin e një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, ose nëse koncesioni/partneriteti publik privat përfshin përdorimin e të mirave publike, atëherë autoriteti kontraktues zgjidh të gjitha marrëdhëniet e pronësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit gjatë periudhës së kontraktuar.

### **Neni 38**

#### **E drejta e pronësisë**

1. Objektet e ndërtuara në bazë të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat, duke përfshirë shtesat dhe përmirësimet, janë në pronësi të autoritetit kontraktues, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratë.
2. Në dokumentacionin e tenderit autoriteti kontraktues duhet të parashikojë kushtet, në bazë të të cilave rregullohen të drejtat e pronësisë, të përshkruara në pikën 1 të këtij neni.
3. Pas zgjidhjes së kontratës, koncesionari/partneri privat është i detyruar të dorëzojë objektet e ndërtuara në bazë të kontratës, pavarësisht nëse ato janë ndërtuar, rindërtuar, ruajtur, pajisur ose përmirësuar, tërësisht ose pjesërisht, sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar në kontratë, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj.
4. Të gjitha çështjet, duke përfshirë edhe kushtet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë, si dhe standardet e kërkuara të cilësisë, janë objekt i analizës së studimit të fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat për atë kontratë dhe të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, si dhe në vetë kontratën.

### **Neni 39**

#### **Subjekti për qëllime të veçanta (SPV)**

1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë në dokumentacionin e tenderit që operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm të krijojë një person juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë, i cili lidh kontratën.
2. Subjekti për qëllime të veçanta mund të marrë pjesë vetëm në realizimin e një kontrate

koncesioni/partneriteti publik privat, për të cilën ai është themeluar.

3. Në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në dokumentacionin e tenderit përcaktohen forma e personit juridik, shuma minimale e kapitalit, detyrimet e ofertuesit më të suksesshëm, në lidhje me themelimin e saj, si dhe marrëdhëniet e tjera midis ofertuesit më të suksesshëm, subjektit për qëllime të veçanta dhe autoritetit kontraktues.

#### **Neni 40**

##### **Interesat e sigurisë**

1. Koncesionari/partneri privat mund sigurojë të drejtat e tij ndaj çdo pagese të çdo lloji të marrë ose që pritet të merret nga ai në zbatim të një kontrate koncesioni/partneriteti publik privat ose në lidhje me të, pa cenuar të drejtën e tij ndaj çdo pjese tjetër të pasurisë së tij. Ky sigurim nuk mund të krijohet pa pëlqimin e autoritetit kontraktues dhe mund të bëhet vetëm në favor të institucioneve financiare për të siguruar pretendimet e këtyre institucioneve, mbi bazën e kontratës së kredisë.

2. Pretendimet e institucionit financiar, sipas pikës 1 të këtij neni, lidhen vetëm me instrumentet financiare të fituara për qëllime të ekzekutimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat dhe nuk përfshijnë asnjë nga pretendimet e tjera që institucionet financiare kanë ndaj koncesionarit/partnerit privat për arsye të tjera.

#### **Neni 41**

##### **Dispozita e stabilizimit**

1. Autoriteti kontraktues mund të hyjë në një angazhim detyrues, në emër të shtetit, që do të ketë efektin e sigurimit të garancive të përshtatshme në favor të koncesionarit/partnerit privat, me të cilin do të mbrohet kundër pasojave financiare të legjislacionit, i cili hyn në fuqi pas fillimit të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, që u nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme:

- a) pasojat financiare duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë dhe të saktë;
- b) angazhimi përfundon me përfundimin e marrëveshjes së koncesionit;
- c) duhet të përshkruhet natyra e legjislacionit.

2. Një angazhim i tillë detyrues miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me kërkesën e autoritetit kontraktues.

#### **Neni 42**

##### **Shfuqizohet<sup>50</sup>**

---

<sup>50</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr.50/2019“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”

## KREU VI

### SHQYRTIMI ADMINISTRATIV

#### Neni 43<sup>51</sup>

##### Procedura e rishikimit administrativ

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes nënjë procedurë konkurruese dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor të koncesionit/partneritetit publik privat, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik.

2. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës konkurruese, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

3. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme, kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhej të ishte vënë në dijeni.

4. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht për dijeni edhe autoritetit kontraktor. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës konkurruese deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi nga KPP-ja.

5. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi përprocedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij.

6. Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim brenda 10 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Kur për shqyrtimin e ankesës kërkohet informacion nga autoriteti kontraktor, KPP-ja përgjigjet me shkrim jo më vonë se 20 ditë.

7. Procedura e rishikimit administrativ dhe vendimmarrja e KPP-së, në përfundim të shqyrtimit të ankesës, bëhen në përputhje me parashikimet përkatëse në legjislacionin e prokurimit publik.

8. Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatë përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.”.

#### Neni 44

##### Detyrimi për bashkëpunim

Refuzimi i nëpunësit civil, i funksionarit ose autoritetit kontraktues për të dhënë informacion apo për të paraqitur dokumentacionin që ka lidhje me procedurën nën hetim administrativ, përbën shkak që Komisioni i Prokurimit Publik, Ministria e Financave ose Agjencia e Prokurimit Publik të kërkojnë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

---

<sup>51</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.

## Neni 45

### Kundërvajtjet administrative

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji nga personat përgjegjës, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 lekë deri në 1 000 000 lekë. Gjoha vendoset nga Agjencia e Prokurimit Publik.
2. Ministri i Financave, Agjencia e Prokurimit Publik ose Komisioni i Prokurimit Publik, kur është rasti, mund t'i propozojnë drejtuesit të autoritetit kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

## Neni 46

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat rregullohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.
2. Koncesionari/partneri privat, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të biznesit janë të lirë të zgjedhin ligjin që rregullon marrëdhëniet e ndërsjella të tyre të biznesit.
3. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit/partnerit privat zgjidhet përmes mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të pranuar nga palët në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë edhe procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar. Në çdo rast, ligji i zbatueshëm është ligji shqiptar në fuqi<sup>52</sup>.
4. Koncesionari/partneri privat, aksionarët e tij dhe ortakët e tjerë të biznesit janë të lirë të zgjedhin mekanizmat e duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

## KREU VII

### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

## Neni 47

### Shfuqizimet

**Ligji nr. 9663, datë 18.12. 2006 "Për koncesionet", i ndryshuar, shfuqizohet.**

## Neni 48

### Zbatimi i dispozitave

Dispozitat e ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, zbatohen për procedurat e dhënies së kontratave të koncesionit dhe për procedurat e shqyrtimit të filluara, si dhe kontratat e lidhura

---

<sup>52</sup> Ndryshuar me Ligjin nr. 77/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar".

para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 49**

#### **Rregulloret për zbatimin e ligjit**

Këshilli i Ministrave, brenda një afati prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton aktet nënligjore në zbatim të pikave 2 dhe 3 të nenit 4, të pikës 2 të nenit 5, të pikës 2 të nenit 7, të pikës 3 të nenit 8, të pikës 3 të nenit 14, të pikës 5 të nenit 16, të pikës 2 të nenit 21, të pikës 5 të nenit 24, të pikës 7 të nenit 25, të pikës 3 të nenit 42, si dhe aktet e tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

#### **Neni 50**

#### **Kontratat e koncesionit të nënshkruara**

Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e koncesionit të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që rregullojnë regjistrin e koncesioneve/partneriteteve publike private, të cilat duhet të rregullohen brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 51<sup>53</sup>**

#### **Shfuqizuar**

#### **Neni 52**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.4.2013

Shpallur me dekretin nr. 8149, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

---

<sup>53</sup> Shfuqizuar me Ligjin nr. 77/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”.